

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70100-26-3132-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **RITENDER -Sigurimi Fizik i Objekteve të QKUK-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	" PSF " SH.P.K.
NUI	810107038
Adresa	Prizren - Rr. Joni nr. 96
Vendi	Prizren
Kodi postar	20000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Mirsad Çollaku
Adresa elektronike	psf.shpk1@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	15.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

RITENDER -Sigurimi Fizik i Objekteve të QKUK-së

NJOFTIMI PER KONTRATE 06.05.2026

17.06.2026 PLANIFIKIMI PER HAPJE

KERKESA PER RISHQRTIM 12.06.2026

VENDIMI AK-SE 15.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

POR POR AK ESHTË THIRRUR Ju informoi se kërkesa për Rishqyrtim është e jashtëafatshme. Autoritet Kontraktues e konsideroim se kërkesa për rishqyrtim është e jashtëafatshme sipas nenit 60.1 të rregullorës 001/2022 Autoriteti Kontraktues ka vepruar gabimisht kur e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim si të pasafatshme pa e shqyrtuar atë në merita.

Neni 60.1 i Rregullores Nr. 001/2022 parashikon se kërkesa për rishqyrtim lidhur me Njoftimin e Kontratës ose Dokumentet e Tenderit duhet të parashtrahet së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Megjithatë, i njëjti nen përmban edhe përjashtimin sipas të cilit ky afat nuk zbatohet në rastet kur bëhet zgjatja e afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të një

kërkese për rishqyrtim.

Në rastin konkret, afati fillestar për dorëzimin e ofertave ka qenë 05.06.2026, ndërsa më pas Autoriteti Kontraktues ka zgatur afatin deri më 17.06.2026 pas procedurës së rishqyrtimit. Kërkesa për Rishqyrtim është dorëzuar më 12.06.2026, gjatë periudhës së zgatur të tenderimit.

Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues është mbështetur vetëm në pjesën e parë të nenit 60.1 dhe nuk ka analizuar fare efektin juridik të zgjatjes së afatit të ofertave, ndonëse kjo rrethanë lidhet drejtpërdrejt me përjashtimin e paraparë në të njëjtën dispozitë.

Për pasojë, para se ta shpallte kërkesën të pasafatshme, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim të vlerësojë nëse zgjatja e afatit të ofertave ka krijuar rrethana që kërkojnë aplikimin e përjashtimit të paraparë në nenin 60.1. Mosshqyrtimi i kësaj çështjeje dhe refuzimi automatik i kërkesës përbën arsyetim të paplotë dhe zbatim jo të plotë të dispozitave relevante të legjislacionit të prokurimit publik.

Për këtë arsye, kërkohet që vendimi për refuzimin e kërkesës si të pasafatshme të anulohet dhe kërkesa për rishqyrtim të shqyrtohet në merita.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Me veprimet, kriteret dhe kërkesat e specifikuar në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka dështuar në mënyrë absolute ta përshtatë procedurën me parimet bazë të prokurimit, duke shkelur direkt dispozitat imperative si në vijim:
Me kriteret, kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me parimet themelore dhe dispozitat detyruese të legjislacionit të prokurimit publik, duke krijuar kufizime të pajustificuara në konkurrencë dhe duke cenuar të drejtën e operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje të barabartë në procedurë. Përmes hartimit të kriterëve të kontestuara, Autoriteti Kontraktues ka dështuar të sigurojë një procedurë të hapur, proporcionale dhe konkurruese, siç kërkohet nga Ligji për Prokurimin Publik dhe legjislacioni sekondar në fuqi, duke shkelur veçanërisht dispozitat si në vijim: Nenet 1, 6 dhe 7 të Ligjit për Prokurimin Publik
Këto dispozita përfaqësojnë bazën themelore të sistemit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës dhe obligojnë çdo Autoritet Kontraktues që gjatë planifikimit dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit të sigurojë përdorim efikas dhe ekonomik të fondeve publike, trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, mosdiskriminim dhe zhvillim të konkurrencës së lirë dhe efektive Në rastin konkret, kriteret e vendosura në Dosjen e Tenderit nuk synojnë zgjerimin e

konkurrencës, por kufizimin e saj, duke krijuar barriera të panevojshme dhe joproporcionale për pjesëmarrje. Përmes këtyre kërkesave është ngushtuar artificialisht tregu relevant dhe janë favorizuar operatorë të caktuar ekonomikë në dëm të operatorëve të tjerë potencialisht të kualifikuar. • Neni 51 i Ligjit për Prokurimin Publik – Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar Neni 51 i LPP-së përcakton qartë se çdo kërkesë minimale e kapacitetit ekonomik dhe financiar duhet të jetë drejtpërdrejt e lidhur dhe proporcionale me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. Ky nen nuk i jep Autoritetit Kontraktues diskrecion të pakufizuar për të vendosur kriteret financiare sipas dëshirës, por e obligon atë që për secilin kriter të ekzistojë një arsyetim objektiv, racional dhe proporcional. Në rastin konkret, kërkesat financiare të vendosura nuk mbështeten në asnjë analizë të dokumentuar, nuk justifikohen me kompleksitetin e kontratës dhe tejkalojnë atë që është e nevojshme për të vlerësuar aftësinë reale të operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratës. • Nenet 59 dhe 61 të Ligjit për Prokurimin Publik Neni 59 rregullon mënyrën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ndërsa neni 61 përcakton procedurën specifike që duhet ndjekur nga Autoriteti Kontraktues në rastet kur ekziston dyshim për ofertë anormalisht të ulët. Përmes kërkesës për paraqitjen e një analize të detajuar financiare që në momentin e dorëzimit të ofertës, Autoriteti Kontraktues ka krijuar një mekanizëm paralel dhe të paparaparë me ligj për kontrollin paraprak të strukturës së çmimeve të ofertuesve. Një qasje e tillë nuk mbështetet në dispozitat e LPP-së dhe përbën shmangie të procedurës ligjore të trajtimit të ofertave anormalisht të ulëta, e cila mund të aktivizohet vetëm pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave dhe vetëm në rastet e përcaktuara me ligj. • Neni 25 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik barabartë, mosdiskriminimit dhe zhvillimit të konkurrencës së lirë. AK ka përdorur pushtetin e tij diskrecionar për të krijuar një mbyllje artificiale të tregut, duke favorizuar subjekte të caktuara. Neni 51 i LPP-së (Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar): Neni 25 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (RUUOPP):

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkëljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1

Pragu i qarkullimit prej 1,000,000.00€ është joproporcional, i paarsyetuar dhe kufizues i konkurrencës, në kundërshtim me nenin 51 të LPP-së dhe nenin 25 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë qarkullim minimal financiar në vlerë prej 1,000,000.00€ gjatë tri viteve të fundit, si kusht për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit. Ankuesi konsideron se kjo kërkesë është vendosur në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, pasi nuk është shoqëruar me asnjë analizë, arsyetim apo vlerësim objektiv që do të demonstronte nevojën reale për një

prag të tillë financiar në raport me objektin, kompleksitetin, kohëzgjatjen dhe rrezikun e kontratës. Neni 51 i Ligjit për Prokurimin Publik obligon Autoritetin Kontraktues që çdo kërkesë e kapacitetit ekonomik dhe financiar të jetë drejtpërdrejt e lidhur dhe proporcionale me kontratën që prokurohet. Në të njëjtën frymë, neni 25 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik kërkon që kriteret e përzgjedhjes të mos krijojnë pengesa të panevojshme për pjesëmarrje dhe të mos kufizojnë konkurrencën përtej asaj që është e domosdoshme për mbrojtjen e interesit legjitim të Autoritetit Kontraktues. Në rastin konkret, Dosja e Tenderit nuk përmban asnjë arsytim që do të demonstronte se një operator ekonomik me qarkullim më të ulët se 1,000,000.00€ nuk do të ishte në gjendje ta realizonte kontratën. Përkundrazi, aftësia për realizimin e kontratës vlerësohet edhe përmes kriterëve të tjera, si referencat e kontratave të ngjashme, licencat profesionale, kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore, të cilat tashmë janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për pasojë, vendosja e një pragu kaq të lartë financiar, pa një arsytim të dokumentuar dhe të verifikueshëm, krijon një kufizim të panevojshëm të konkurrencës dhe redukton numrin e operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë në procedurë, duke cenuar drejtpërdrejt parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive të garantuara me nenet 6 dhe 7 të LPP-së. Për më tepër, ky kriter prek veçanërisht operatorët ekonomikë të mesëm dhe të vegjël, të cilët mund të posedojnë përvojën profesionale, licencat dhe kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, por përjashtohen nga pjesëmarrja vetëm për shkak të një pragu financiar të vendosur pa arsytim të mjaftueshëm. Një qasje e tillë bie ndesh edhe me qëllimin themelor të legjislacionit të prokurimit publik, i cili synon të sigurojë pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe zhvillimin e konkurrencës reale në treg. Duke qenë se Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë analizë financiare, ekonomike apo operative që do të justifikonte proporcionalitetin e këtij kriteri, Ankuesi konsideron se kërkesa për qarkullim minimal prej 1,000,000.00€ është e paarsyetuar, joproportionale dhe si e tillë duhet të shfuqizohet ose të riformulohet në përputhje me kërkesat e nenit 51 të LPP-së dhe nenit 25 të Rregullores për Prokurimin Publik.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2

Kërkesa që qarkullimi financiar të jetë realizuar ekskluzivisht në fushën e sigurisë
5/3

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

është joproportionale, diskriminuese dhe kufizuese e konkurrencës, në kundërshtim me nenet 6, 7 dhe 51 të LPP-së

Përveç kërkesës për qarkullim minimal prej 1,000,000.00€, Autoriteti Kontraktues ka vendosur edhe kushtin shtesë që ky qarkullim të jetë realizuar ekskluzivisht në fushën e sigurisë.

Ankuesi konsideron se ky kusht tejkalon kufijtë e lejuar të vlerësimit të kapacitetit ekonomik dhe financiar dhe përbën një kufizim të pajustificuar të konkurrencës, në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Qëllimi i vlerësimit të kapacitetit ekonomik dhe financiar është të verifikohet nëse operatori ekonomik posedon stabilitet financiar, likuiditet dhe aftësi ekonomike të mjaftueshme për të realizuar kontratën. Ky qëllim arrihet përmes analizimit të qarkullimit, gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorit, e jo përmes kufizimit të burimit të këtij qarkullimi në një sektor të vetëm ekonomik.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar asnjë arsytim objektiv se përse një operator ekonomik me kapacitete të dëshmuara financiare, i cili ka realizuar qarkullim të konsiderueshëm në sektorë të tjerë ekonomikë, do të konsiderohej më pak i aftë për realizimin e kësaj kontrate.

Për më tepër, Dosja e Tenderit tashmë përmban kriteret të veçanta për vlerësimin e përvojës profesionale dhe teknike, përfshirë kërkesën për kontrata të ngjashme, licenca profesionale, certifikime dhe kapacitete teknike. Për rrjedhojë, përvoja në sektorin e sigurisë është trajtuar tashmë përmes kriterëve profesionale dhe teknike, ndërsa përdorimi i të njëjtit element edhe në kriterin e kapacitetit financiar përbën një kufizim të dyfishtë dhe të panevojshëm.

Një operator ekonomik mund të posedojë kapacitete të konsiderueshme financiare, menaxheriale dhe organizative, të fituara përmes realizimit të kontratave komplekse në sektorë të ndryshëm ekonomikë, dhe megjithatë të përjashtohet nga kjo procedurë vetëm për shkak të natyrës së aktivitetit nga i cili është gjeneruar qarkullimi i tij. Një qasje e tillë nuk lidhet me aftësinë reale financiare të operatorit, por me një kufizim artificial të pjesëmarrjes në procedurë.

Për rrjedhojë, kërkesa që qarkullimi minimal prej 1,000,000.00€ të jetë realizuar ekskluzivisht në fushën e sigurisë nuk është e lidhur në mënyrë proporcionale me qëllimin e vlerësimit të kapacitetit ekonomik dhe financiar, kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë potencialisht të kualifikuar dhe cenon parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës efektive të garantuara me nenet 6 dhe 7 të LPP-së.

Për këto arsye, Ankuesi kërkon që ky kriter të shfuqizohet ose të modifikohet, në mënyrë që qarkullimi i kërkuar të vlerësohet mbi bazën e kapacitetit financiar të përgjithshëm të operatorit ekonomik dhe jo mbi bazën e një kufizimi sektorial të pajustificuar.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3

Kërkesa për paraqitjen e analizës financiare së bashku me ofertën përbën përzierje të kriterëve të kualifikimit me vlerësimin e ofertës financiare dhe është në kundërshtim me procedurën e paraparë në nenin 61 të LPP-së

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin, që në momentin e dorëzimit të ofertës, një analizë financiare të detajuar e cila duhet të përfshijë pagat, shtesat për punë gjatë natës, vikendeve dhe festave, pushimet vjetore, kontributet pensionale, fitimin e operatorit ekonomik, TVSH-në dhe elemente të tjera të strukturës së kostos.

Ankuesi konsideron se kjo kërkesë nuk përbën kriter të kapacitetit ekonomik dhe financiar në kuptim të nenit 51 të LPP-së, por lidhet drejtpërdrejt me përmbajtjen dhe strukturën e ofertës financiare të operatorit ekonomik.

Legjislacioni i prokurimit publik bën dallim të qartë ndërmjet fazës së verifikimit të përshtatshmërisë së operatorëve ekonomikë dhe fazës së vlerësimit të ofertave. Kriteret e kualifikimit kanë për qëllim të vlerësojnë aftësinë juridike, ekonomike, financiare dhe teknike të operatorit për të realizuar kontratën, ndërsa analiza e strukturës së çmimit lidhet me ofertën ekonomike dhe trajtimin e saj gjatë fazës së vlerësimit.

Në këtë kontekst, neni 61 i LPP-së rregullon procedurën e trajtimit të ofertave anormalisht të ulëta dhe parasheh mundësinë që Autoriteti Kontraktues të kërkojë sqarime lidhur me elementet përbërëse të çmimit vetëm pasi ofertat janë dorëzuar, hapur dhe vlerësuar, dhe vetëm në rastet kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme mbi qëndrueshmërinë e ofertës.

Përmes kërkesës që të gjithë operatorët ekonomikë të dorëzojnë paraprakisht analizë të

detajuar të kostove, Autoriteti Kontraktues ka krijuar një mekanizëm të veçantë dhe të paparaparë me ligj për shqyrtimin paraprak të strukturës së çmimeve, pavarësisht nëse ekziston apo jo ndonjë dyshim për ofertë anormalisht të ulët.

Për më tepër, Dosja e Tenderit nuk sqaron nëse kjo analizë financiare do të përdoret si kriter eliminues, si dokument informues apo si bazë për vlerësimin e pranueshmërisë së ofertës. Mungesa e një metodologjie të qartë të vlerësimit krijon pasiguri juridike dhe i lë Autoritetit Kontraktues një hapësirë të gjerë interpretimi gjatë procesit të shqyrtimit të ofertave.

Një kërkesë e tillë cenon parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, pasi operatorët nuk janë në gjendje të kuptojnë paraprakisht se si do të vlerësohet dokumenti i kërkuar dhe cilat do të jenë pasojat juridike të mospërputhjeve eventuale në përmbajtjen e tij.

Për rrjedhojë, kërkesa për paraqitjen e analizës financiare së bashku me ofertën nuk është e lidhur me vlerësimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë, përbën përzierje të fazave të procedurës së prokurimit dhe krijon një mekanizëm vlerësimi që nuk mbështetet në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Për këtë arsye, Ankuesi kërkon që kjo kërkesë të largohet nga Dosja e Tenderit ose të riformulohet në përputhje me dispozitat e LPP-së.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 4

Kërkesa për deklarimin e fitimit të planifikuar tejkalon kompetencat e Autoritetit Kontraktues dhe cenon konfidencialitetin e informacionit afarist

Në kuadër të analizës financiare të kërkuar me Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues obligon operatorët ekonomikë që të paraqesin edhe fitimin e planifikuar si pjesë përbërëse të ofertës së tyre.

Ankuesi konsideron se kjo kërkesë nuk ka asnjë lidhje me vlerësimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë dhe për rrjedhojë tejkalon qëllimin e kriterëve të kualifikimit të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Fitimi i planifikuar përbën element të politikës komerciale dhe strategjisë afariste të secilit operator ekonomik. Niveli i fitimit që një operator ekonomik vendos të realizojë në një kontratë të caktuar është rezultat i vendimeve të tij të brendshme biznesore, i strukturës së kostove, strategjisë së tregut, nivelit të rrezikut që është i gatshëm të marrë përsipër dhe objektivave të tij komerciale.

Asnjë dispozitë e Ligjit për Prokurimin Publik nuk autorizon Autoritetin Kontraktues që, gjatë fazës së kualifikimit apo vlerësimit të ofertave, të kërkojë zbulimin e detyrueshëm të marzhës së fitimit të operatorëve ekonomikë. Po ashtu, legjislacioni i prokurimit publik nuk i njeh Autoritetit Kontraktues kompetencën për të vlerësuar nëse fitimi i planifikuar nga një operator ekonomik është i pranueshëm, i arsyeshëm apo i mjaftueshëm.

Për më tepër, informacioni mbi marzhën e fitimit përbën informacion komercial sensitiv dhe pjesë të know-how-it afarist të operatorit ekonomik. Kërkesa për zbulimin e detyrueshëm të këtij informacioni cenon interesat legjitime biznesore të operatorëve ekonomikë dhe bie ndesh me parimin e mbrojtjes së informacionit konfidencial të paparaparë në nenin 11 të LPP-së.

Veçanërisht problematik mbetet fakti se Dosja e Tenderit nuk sqaron arsyen ligjore dhe praktike për të cilën kërkohet ky informacion, mënyrën e përdorimit të tij gjatë vlerësimit të ofertave dhe ndikimin që ai mund të ketë në rezultatin e procedurës.

Në mungesë të një baze ligjore të qartë dhe të një qëllimi të ligjshëm të lidhur me

realizimin e kontratës, kërkesa për deklarimin e fitimit të planifikuar paraqet një ndërhyrje të pajustificuar në sferën komerciale të operatorëve ekonomikë dhe krijon barrë të panevojshme administrative për pjesëmarrësit në procedurë.

Për rrjedhojë, Ankuesi konsideron se kjo kërkesë është e paligjshme, joproportionale dhe e pambështetur në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, andaj kërkon largimin e saj nga Dosja e Tenderit.

Përveç sa u tha më sipër, kërkesa për deklarimin e fitimit të planifikuar është edhe më problematike për faktin se Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar asnjë metodologji, standard apo kriter objektiv për vlerësimin e këtij informacioni.

Dosja e Tenderit nuk sqaron nëse fitimi i deklaruar do të merret parasysh gjatë vlerësimit të ofertave, nuk përcakton nëse ekziston ndonjë nivel minimal apo maksimal i pranueshëm i fitimit dhe nuk specifikon nëse një fitim i konsideruar nga Autoriteti Kontraktues si "i lartë" apo "i ulët" mund të ndikojë në pranueshmërinë e ofertës.

Në këto rrethana, operatorët ekonomikë detyrohen të paraqesin informacione të ndjeshme komerciale pa qenë në dijeni të qëllimit për të cilin ato kërkojnë dhe pa ditur se si do të përdoren gjatë procesit të vlerësimit.

Mungesa e një metodologjie të qartë të vlerësimit është në kundërshtim me parimet e transparencës, sigurisë juridike dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, pasi i jep Autoritetit Kontraktues një hapësirë të gjerë dhe të pakufizuar interpretimi gjatë shqyrtimit të ofertave.

Për më tepër, nëse informacioni lidhur me fitimin nuk përdoret për qëllime vlerësimi, atëherë kërkesa është e panevojshme dhe pa relevancë juridike për procedurën e prokurimit. Nëse, nga ana tjetër, ky informacion synohet të përdoret gjatë vlerësimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të përcaktojë paraprakisht kriteret, metodologjinë dhe pasojat juridike të këtij vlerësimi, gjë që nuk është bërë në rastin konkret.

Për rrjedhojë, kërkesa për deklarimin e fitimit të planifikuar jo vetëm që cenon konfidencialitetin e informacionit afarist, por gjithashtu krijon pasiguri juridike dhe mundësi për trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke e bërë atë të papajtueshme me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 5

Përzjerja e kriterëve të kualifikimit me elementet e ofertës ekonomike krijon pasiguri juridike dhe bie ndesh me nenet 51 dhe 59 të LPP-së

Autoriteti Kontraktues ka përfshirë kërkesën për paraqitjen e analizës financiare të ofertës në kapitullin e kapacitetit ekonomik dhe financiar, megjithëse përmbajtja e këtij dokumenti lidhet drejtpërdrejt me strukturën e çmimit dhe ofertën ekonomike të operatorit ekonomik.

Ankuesi konsideron se kjo qasje është në kundërshtim me strukturën dhe logjikën e sistemit të prokurimit publik, i cili bën dallim të qartë ndërmjet kriterëve të kualifikimit e vlerësimit të ofertave.

Sipas nenit 51 të Ligjit për Prokurimin Publik, kriteret e kapacitetit ekonomik dhe financiar kanë për qëllim të vlerësojnë aftësinë dhe qëndrueshmërinë financiare të

operatorit ekonomik, bazuar në gjendjen e tij financiare, përvojën dhe kapacitetet e dëshmuara para dorëzimit të ofertës.

Në anën tjetër, neni 59 i LPP-së rregullon procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ku përfshihen elementet financiare dhe ekonomike të ofertës së paraqitur për procedurën konkrete të prokurimit.

Në rastin konkret, analiza financiare e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues nuk ka të bëjë me kapacitetin ekonomik të operatorit ekonomik, por me mënyrën se si operatori ka ndërtuar çmimin e ofertës së tij. Përmbajtja e saj përfshin elemente si pagat, shtesat ligjore, kontributet pensionale, fitimin e operatorit ekonomik, TVSH-në dhe komponentë të tjerë të kostos, të cilët lidhen ekskluzivisht me ofertën financiare dhe jo me kapacitetin kualifikues të operatorit ekonomik.

Përfshirja e një dokumenti të tillë në seksionin e kapacitetit ekonomik dhe financiar krijon paqartësi serioze lidhur me natyrën juridike të kërkesës dhe mënyrën e trajtimit të saj gjatë procesit të vlerësimit. Operatorët ekonomikë nuk janë në gjendje të kuptojnë nëse analiza financiare përbën kriter kualifikues, kriter eliminues, dokument informues apo element të ofertës ekonomike që do të shqyrtohet gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Kjo paqartësi cenon parimin e transparencës dhe sigurisë juridike, pasi kriteret e Dosjes së Tenderit duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të parashikueshme për të gjithë operatorët ekonomikë. Çdo operator duhet të jetë në gjendje të kuptojë paraprakisht se cilat dokumente kërkohen, për çfarë qëllimi kërkohen dhe cilat janë pasojat juridike të mosdorëzimit ose të mospërmbushjes së tyre.

Për më tepër, mungesa e një ndarjeje të qartë ndërmjet kriterëve të kualifikimit dhe elementeve të ofertës ekonomike krijon rrezik real për interpretim të ndryshëm gjatë procesit të vlerësimit dhe mund të çojë në trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për rrjedhojë, Ankuesi konsideron se përfshirja e analizës financiare në kapitullin e kapacitetit ekonomik dhe financiar është në kundërshtim me nenet 51 dhe 59 të LPP-së, cenon transparencën dhe sigurinë juridike të procedurës dhe duhet të korrigohet nga Autoriteti Kontraktues.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 6

Mungesa e metodologjisë së vlerësimit të analizës financiare cenon transparencën, sigurinë juridike dhe bie ndesh me nenin 59 të LPP-së
10/3

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin një analizë financiare të detajuar si pjesë të ofertës së tyre, mirëpo në Dosjen e Tenderit nuk ka përcaktuar asnjë metodologji, standard objektiv apo kriter të matshëm mbi bazën e të cilit do të vlerësohet kjo analizë.

Ankuesi konsideron se kjo paraqet një shkelje serioze të parimit të transparencës dhe sigurisë juridike, pasi operatorët ekonomikë nuk janë në gjendje të kuptojnë paraprakisht se cilat janë kërkesat konkrete që duhet të plotësojë analiza financiare për t'u konsideruar e pranueshme.

Në mënyrë specifike, Dosja e Tenderit nuk përcakton:

? cili është standardi minimal i pranueshmërisë së analizës financiare;

? cilat elemente të analizës do të vlerësohen nga Autoriteti Kontraktues;

? cilat mospërputhje eventuale do të konsiderohen materiale apo jomateriale;

? nëse ekziston ndonjë formulë, metodologji apo model referues për verifikimin e analizës;
? nëse mospërputhjet në analizë do të rezultojnë me kërkesë për sqarime apo me eliminim të ofertës;
? cilat janë pasojat juridike të mosdorëzimit apo të paraqitjes së një analize që Autoriteti Kontraktues mund ta konsiderojë të papranueshme.

Për pasojë, operatorët ekonomikë obligohen të paraqesin një dokument për të cilin nuk ekzistojnë rregulla të qarta vlerësimi, duke mos pasur mundësi të parashikojnë se si do të trajtohet ai gjatë procesit të shqyrtimit të ofertave.

Neni 59 i Ligjit për Prokurimin Publik kërkon që procesi i ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave të zhvillohet mbi baza objektive, transparente dhe të paracaktuara. Në të njëjtën kohë, parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit kërkojnë që të gjitha kriteret dhe kushtet që mund të ndikojnë në rezultatin e procedurës të jenë të qarta, të matshme dhe të njohura paraprakisht për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një dokument të cilit nuk i ka përcaktuar as kriteret e pranueshmërisë dhe as metodologjinë e vlerësimit. Kjo krijon një situatë ku vlerësimi i analizës financiare mund të mbështetet në interpretime subjektive dhe jo në standarde objektive të shpallura paraprakisht në Dosjen e Tenderit.

ndryshëm të trajtohen në mënyrë të ndryshme për të njëjtat rrethana faktike, gjë që cenon drejtpërdrejt parimin e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme.

Për rrjedhojë, kërkesa për analizë financiare, pa përcaktimin e metodologjisë së vlerësimit, standardeve të pranueshmërisë dhe pasojave juridike që lidhen me të, është në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe me parimet themelore të 11/3

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK
transparencës, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike, andaj duhet të largohet ose të riformulohet në mënyrë të qartë dhe të matshme nga Autoriteti Kontraktues. PRETENDIMI ANKIMOR NR. 7

Paqartësi juridike lidhur me natyrën, statusin dhe pasojat e analizës financiare, në kundërshtim me parimet e transparencës dhe sigurisë juridike

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar paraqitjen e një analize financiare të detajuar si pjesë e dokumentacionit të ofertës, mirëpo në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk ka përcaktuar natyrën juridike të këtij dokumenti, mënyrën e trajtimit të tij gjatë vlerësimit dhe pasojat juridike që mund të rrjedhin nga mosdorëzimi apo nga mospërputhjet eventuale në përmbajtjen e tij.

Ankuesi konsideron se kjo paraqet një mangësi serioze në hartimin e Dosjes së Tenderit dhe cenon drejtpërdrejt parimet e transparencës, sigurisë juridike dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Konkretisht, Dosja e Tenderit nuk sqaron:

? nëse analiza financiare përbën kriter të përshtatshmërisë;

? nëse ajo përbën kriter të përzgjedhjes;

? nëse paraqet element të ofertës ekonomike;

? apo nëse ka karakter thjesht informues për Autoritetin Kontraktues.

Po ashtu, Dosja e Tenderit nuk përcakton nëse mosdorëzimi i këtij dokumenti do të rezultojë me eliminimin e ofertës, nëse do të kërkohej sqarime shtesë nga operatori ekonomik apo nëse dokumenti do të merret parasysh vetëm për qëllime të brendshme të

vlerësimit.

Në mungesë të këtyre sqarimeve, operatorët ekonomikë nuk janë në gjendje të kuptojnë paraprakisht rëndësinë juridike të dokumentit të kërkuar dhe as ndikimin që ai mund të ketë në rezultatin e procedurës së prokurimit.

Një Dosje Tenderi duhet të jetë e qartë, e saktë dhe e parashikueshme, në mënyrë që secili operator ekonomik të dijë me saktësi se cilat janë kërkesat që duhet të përmbushë dhe cilat janë pasojat juridike të mosplotësimit të tyre. Çdo kërkesë që mund të ndikojë në pranueshmërinë e ofertës duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të mos lihet në interpretim të mëvonshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Në rastin konkret, mungesa e përcaktimit të statusit juridik të analizës financiare krijon pasiguri të konsiderueshme dhe i jep Autoritetit Kontraktues një hapësirë të panevojshme diskrecioni gjatë procesit të vlerësimit, duke rrezikuar trajtim jo të njëjtë të operatorëve

Për më tepër, kur një dokument kërkohet si pjesë e ofertës, por nuk përcaktohet qartë funksioni dhe rëndësia e tij juridike, operatorët ekonomikë vendosen në një pozitë të pafavorshme dhe të paqartë, gjë që bie ndesh me standardet e transparencës dhe parashikueshmërisë që duhet të karakterizojnë çdo procedurë të prokurimit publik. Për rrjedhojë, Ankuesi konsideron se kërkesa për analizë financiare, pa përcaktimin e qartë të statusit juridik, mënyrës së trajtimit dhe pasojave të saj administrative apo procedurale, është në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik dhe duhet të largohet ose të sqarohet në mënyrë të plotë përmes korrigjimit të Dosjes së Tenderit.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 8

Kërkesa e njëkohshme për qarkullim financiar prej 1,000,000.00€ dhe kontrata të ngjashme në të njëjtën vlerë përbën dyfishim joproportional të kriterëve kualifikuese dhe kufizim të konkurrencës

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar njëkohësisht:

? qarkullim minimal financiar prej 1,000,000.00€ gjatë periudhës së kërkuar; dhe

? dëshmi të kontratave të ngjashme në vlerë prej 1,000,000.00€.

Ankuesi konsideron se këto dy kërkesa, të marra së bashku, krijojnë një barrë të dyfishtë dhe joproportionale për operatorët ekonomikë, pasi synojnë të provojnë në mënyrë të përsëritur aftësinë e operatorit për realizimin e kontratës.

Neni 51 i LPP-së dhe neni 25 i Rregullores Nr. 001/2022 kërkojnë që kriteret e përzgjedhjes të jenë proporcionale me objektin e kontratës dhe të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për verifikimin e kapacitetit të operatorit ekonomik.

Në rastin konkret, përvoja profesionale dhe aftësia për realizimin e kontratës tashmë provohen përmes kërkesës për kontrata të ngjashme. Në të njëjtën kohë, stabiliteti ekonomik dhe financiar provohet përmes qarkullimit financiar. Megjithatë, kur të dy kriteret vendosen në pragje jashtëzakonisht të larta dhe në të njëjtën vlerë financiare prej 1,000,000.00€, efekti praktik është eliminimi i operatorëve ekonomikë që mund të plotësojnë njërin kriter në nivel të lartë, por jo domosdoshmërisht tjetrin.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë analizë apo arsyetim objektiv që do të demonstronte pse është e domosdoshme që operatori ekonomik të dëshmojë njëkohësisht qarkullim dhe referenca kontratash në të njëjtën vlerë financiare. Mungesa e këtij arsyetimi e bën kriterin joproportional dhe në kundërshtim me parimin e konkurrencës efektive.

IV. PËRFUNDIMI

Nga të gjitha faktet, argumentet juridike dhe shkeljet e detajuara më sipër rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues ka hartuar Dosjen e Tenderit në kundërshtim me dispozitat imperative të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Kriteret e vendosura në seksionin e kapacitetit ekonomik dhe financiar nuk janë hartuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit, nuk janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektin e kontratës dhe tejkalojnë atë që është e nevojshme për të vlerësuar aftësinë reale të operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratës.

Veçanërisht, kërkesa për qarkullim minimal prej 1,000,000.00€, e kufizuar ekskluzivisht në fushën e sigurisë, përbën një barrierë të panevojshme dhe diskriminuese ndaj operatorëve ekonomikë, duke kufizuar konkurrencën efektive në treg dhe duke favorizuar vetëm një numër të kufizuar operatorësh ekonomikë.

Po ashtu, kërkesa për paraqitjen e analizës financiare së bashku me ofertën përbën një kriter të paqartë, të pambështetur në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe në kundërshtim me procedurën e paraparë për trajtimin e ofertave anormalisht të ulëta sipas nenit 61 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues ka përzier në mënyrë të pajustificuar kriteret e kualifikimit me elementet e ofertës ekonomike, ka kërkuar zbulimin e informacioneve sensitive komerciale, përfshirë fitimin e operatorëve ekonomikë, si dhe ka dështuar të përcaktojë metodologjinë, standardet e vlerësimit dhe pasojat juridike që lidhen me analizën financiare të kërkuar.

Këto mangësi krijojnë pasiguri juridike, cenojnë transparencën e procedurës, rrezikojnë trajtimin jo të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe janë në kundërshtim me parimet themelore të konkurrencës së lirë, proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të garantuara nga nenet 1, 6 dhe 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar njëkohësisht dëshmimin e kapacitetit ekonomik përmes qarkullimit prej 1,000,000.00€ dhe dëshmimin e përvojës profesionale përmes kontratave të ngjashme në të njëjtën vlerë prej 1,000,000.00€, duke krijuar një barrë të dyfishtë dhe joproporcionale për operatorët ekonomikë pa ndonjë arsyetim objektiv dhe të dokumentuar.

V. KËRKESA

Duke u bazuar në nenet 105, 108/A dhe dispozitat tjera relevante të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Ankuesi i propozon Organit Shqyrtues të Prokurimit që pas shqyrtimit të kësaj ankese të nxjerrë:

VENDIM

- I. Të aprovohet si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik Ankues;
- II. Të konstatohet se Dosja e Tenderit dhe Njoftimi për Kontratë përmbajnë kritere dhe kërkesa që nuk janë në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik;
- III. Autoriteti Kontraktues të bëjë korrigjimin e Dosjes së Tenderit, duke eliminuar ose riformuluar kërkesat e kundërshtuara, përfshirë por pa u kufizuar në:
? kërkesën për qarkullim minimal prej 1,000,000.00€;
? kufizimin që qarkullimi të jetë ekskluzivisht në fushën e sigurisë;

? kërkesën për paraqitjen e analizës financiare si dokument i detyrueshëm i ofertës;
? kërkesën për deklarimin e fitimit të operatorit ekonomik;
? kërkesat e paqarta lidhur me metodologjinë dhe mënyrën e vlerësimit të analizës financiare;
? çdo kërkesë tjetër që kufizon konkurrencën ose nuk është e mbështetur në dispozitat e LPP-së.

IV. Autoriteti Kontraktues të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave pas korigjimit të Dosjes së Tenderit, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi reale dhe të barabartë për përgatitjen e ofertave;

V. Obligohet Autoriteti Kontraktues që procedurën e prokurimit ta zhvillojë në përputhje të plotë me parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës efektive të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

MIS DHENJIA E MUNDESIS PER PJESMARRJE.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrë më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*